



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 143, datë 12.11.2021

PËR

MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË ANEKSIN 2, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 30, DATË 26.03.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 1032, RRUGA “ALEKS KOMENI” DHE PALLATIN “KASTRATI”, RRUGA “RAMADAN VELIU”, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Urdhërit nr.164, datë 01.07.2020 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit”, i ndryshuar, raportit dhe relacionit përkatës hartuar nga Komisioni i Posaçëm, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e Raportit nr. 2145/51 Prot., datë 20.10.2021 hartuar nga Komisioni i Posaçëm për përkjet listës së përfituesve, që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin “Kastrati” Lagja Nr.17, Rruga “Ramadan Veliu”, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Miratimin e disa ndryshimeve në Aneksin 2, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 30, datë 26.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr. 1032, rruga “Aleks Komeni” dhe pallatin “Kastrati”, rruga “Ramadan Veliu”, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019” i ndryshuar, sipas aneksit bashkëngjitur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Miratimin e korrigjimit të gabimit material, përsa i përket korrigjimit të mbiemrit të përfituesit me nr.rendor 42, të përfshirë në Aneksin 2, të VKB-së nr.30, datë 26.03.2021 si vijon: Andon Kushi, Habibe Kushi.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 12.11.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KOMISIONI I POSAÇËM

Nr. 2145 / Prot.
51

Durrës, më 20 . 10 . 2021



RAPORT

**PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË ANEKSIN 2
BASHKALIDHUR VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 30 DATË 26.03.2021, I
NDRYSHUAR, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE QË DO TË
PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN
KASTRATI, RRUGA "RAMADAN VELIU", I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA
NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019.**

Baza Ligjore: Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar", ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë" të ndryshuar, Aktin Normativ nr. 9, datë datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, i cili, ka si objekt kryesor të rregullojë funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse. Vendimin nr. 904, datë 24.12.2019, "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", të ndryshuar.

E nderuar zonja Kryetare,

Me Vendimin nr. 30 datë 26.03.2021, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak ndër të tjera ka miratuar edhe listën e përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për Pallatin "Kastrati", Rruga "Ramadan Veliu", Njësia Administrative Nr.5, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 Nëntor 2019, hartuar nga Komisioni i Posaçëm sipas aneksit 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

Duke qënë se ASHK vijon me kthimin e përgjigjeve lidhur me konfirmimin e pronësisë, si dhe plotësimin e dokumentacionit nga Njësia Administrative nr. 5, Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ka kryer shqyrtimin dhe kualifikimin e dosjeve të pronarëve të apartamenteve respektive të pallatit “Kastrati”, rruga "Ramadan Veliu".

Ky dokumentacion dhe kjo listë e subjekteve përfituese i vihet në dispozicion Komisionit të Posaçëm nga Zyra e Posaçme e Rindërtimi, nëpërmjet :

1. Raportit nr. 2145/46 prot. datë 20.10.2021 për Pallatin Kastrati Rruga “Ramadan Veliu” ku kanë kualifikuar dhjetë subjekte përfituese nga të cilat shtatë subjekte kanë aplikuar në platformën “Shtëpia ime” duke marrë gjendjen familjare të datës së aplikimit, si edhe tre subjekte që nuk kanë bërë aplikim tek platforma “Shtëpia Ime”. Lidhur me tre subjektet që nuk kanë bërë aplikim tek platforma “Shtëpia Ime”, Zyra e Posaçme e Rindërtimit ka shqyrtuar dhe i ka kualifikuar, duke marrë parasysh përbërjen familjare të datës 26 nëntor 2019.

Kjo listë e subjekteve, përfiton nga programi i procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve mbi disa programe të procesit të rindërtimit”, i ndryshuar.

Gjithashtu me Vendimin nr. 30 datë 26.03.2021, në Aneksin 2 me numër rendor 42 është miratuar subjekt përfitues Andon Kushi, Habibe Dauti. Për shkak të një gabimi material, mbiemri i zj. Habibe duhet të bëhet Kushi.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin e sipërpërmendur dhe procedurës së ndjekur nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike dhe Komisioni i Posaçëm, kërkohet:

1. Miratimi i disa shtesave në Aneksin 2 bashkalidhur Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 30 datë 26.03.2021, i ndryshuar, për sa i përket listës së përfituesve që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin Kastrati, rruga “Ramadan Veliu”, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019 si më poshtë vijon:



Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
93	ARTAN TILA, ERITA TILA	5	3+1
94	BETIM HALILAGA, FLORA HALILAGA	4	2+1
95	SHPETIM KIKRI, ILIRJANA KIKRI	6	3+1
96	ANA PAPADHRAMIDHI, KRISTO PAPADHRAMIDHI	4	2+1
97	ADRIAN SHAHOLLI	3	2+1
98	AHMET MENIKU, ZYDI MENIKU, MIMOZA MENIKU	4 (1+3)	2+1
99	RAMADAN CELMANAJ	4	2+1
101	BENET KARAJ	6	3+1
102	ALTIN KOVACI	4	2+1
103	ERTA SPAHO	3	2+1

2.Miratimi i korigjimit të gabimit material të subjektit përfitues me numër rendor 42. përkatësisht si më poshtë vijon:

Ishte

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
42	ANDON KUSHI, HABIBE DAUTI	8	3+1

Bëhet

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
42	ANDON KUSHI, HABIBE KUSHI	8	3+1

KOMISIONI I POSAÇËM:

Gentian Kallmi	Kryetar	
Ermal Lufo	Anëtar	
Andri Cerri	Anëtar	
Diana Mandia	Anëtare	
Klara Agasi	Anëtare	
Edvin Hysi	Anëtar	
Afroviti Manthjo	Anëtare	
Erjon Meka	Anëtar	



Aneksi nr. 2. (Shtese)

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
93	ARTAN TILA, ERITA TILA	5	3+1
94	BETIM HALILAGA, FLORA HALILAGA	4	2+1
95	SHPETIM KIKRI, ILIRJANA KIKRI	6	3+1
96	ANA PAPADHRAMIDHI, KRISTO PAPADHRAMIDHI	4	2+1
97	ADRIAN SHAHOLLI	3	2+1
98	AHMET MENIKU, ZYDI MENIKU, MIMOZA MENIKU	4 (1+3)	2+1
99	RAMADAN CELMANAJ	4	2+1
101	BENET KARAJ	6	3+1
102	ALTIN KOVACI	4	2+1
103	ERTA SPAHO	3	2+1






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 915 / prot.
2



Durrës, më 17 . 11 .2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK ✓
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.143 datë 12.11.2021 “Për miratimin e disa ndryshimeve në Aneksin 2, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 30, datë 26.03.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit për pallatin nr. 1032, rruga “aleks komeni” dhe pallatin “Kastrati”, rruga “Ramadan Veliu”, të dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, i ndryshuar”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

